

Të gjithë Prindërve të nxënësve në klasën e 8^{të},

Në rast se keni aplikuar në procesin e përzgjedhjes së shkollës vjeshtën e vitit të kaluar (p.sh për shkollën e mesme që dëshironi për fëmijën tuaj), ju lutemi i kushtoni vemëndje të veçantë si më poshtë:

Letra njoftuese për përzgjedhjen e shkollës NUK do të dërgohet këtë vit nga shërbimi postar i U. S.! Mos pritni letër nga posta. Mos harroni datat:

5 Mars deri 12 Mars- 2015

Për nxënësit që janë aktualisht në klasat e 8^{ta} dhe ndjekin shkollat e Drejtorisë Arsimore të Filadelfias, njoftimi për përzgjedhjen e shkollave do të bëhet në *Portalin e Nxënësve dhe Portalin Prindi & Familja (Student Portal and Parent & Family Portal)* ([Klikoni këtu](#)) ditën e Enjte, data 5 Mars 2015 ora 6:00 pm. **Këshilltarët e Drejtorisë Arsimore do të kenë të njejtin akses për këto njoftime për nxënësit e shkollave të tyre. Ju lutemi drejtohuni në shkollën e fëmijës tuaj në datat 5 Mars deri 12 Mars 2015 dhe kontaktoni këshilltarin e shkollës për ndihmë.**

Për nxënësit që janë aktualisht në klasat e 8^{ta} dhe **nuk** ndjekin shkollat e Drejtorisë Arsimore të Filadelfias, por kanë aplikuar për në shkollat e saj për vitin shkollor 2015-2016, njoftimi me email do të dërgohet rreth orës 6:00 pm, ditën e Enjte, datë 5 Mars 2015. Njoftimi do të dërgohet në adresën e email_it të shënuar në aplikimin tuaj.

Të gjitha vendimet për shkollën që do të përzgjidhni duhet të dërgohen, ose të kthehen në Drejtorinë Arsimore, deri në orën 6:00 pm të ditës së Enjte, datë 12 Mars. Në qoftë se ky vendim nuk është marrë deri në orën 6:00 pm të ditës së Enjte, datë 12 Mars, miratimi i shkollës të përzgjedhur për nxënësin do të anulohet.

Ju lutemi ndajeni këtë njoftim të rëndësishëm me prindërit e tjerë që kanë fëmijë në klasën e 8^{të}, të cilët flasin gjuhën shqipe